



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 981/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Donika Surdulli, kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër rezultatit përfundimtar për Kuvend Komunal të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale të datës 03.11.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Donika Surdulli, kandidate për anëtar të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

Arsyetim

PZAP-i ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Donika Surdulli kandidate për anëtare të kuvendit komunal në Prishtinë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), ne të cilën pretendon se iu janë vjedhur votat brenda partisë ku komisionarët kanë manipuluar me vota duke i kaluar votat e mija te kandidati tjetër. Parashtruesi i ankesës thekson se si rast konkret ka qenë në shkollën fillore “Mitrush Kuteli”, në Mat ku votat e familjes së ngushtë nuk gjenden, në shkollën Dardania, Zenel Hajdini, Nazim Gafurri, të cilën në bazë të vëzhguesve gjatë numërimit del numri më i madh i votave se sa rezultati përfundimtar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloohen vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikojë cilindo nga vendimet marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Pretendimet ankimore të palës ankuese, se i mungojnë votat në Vendvotimet në shkollat “Mitrush Kuteli”, “Dardania”, “Zenel Hajdini”, “Nazim Gafurri”, PZAP-i konstaton se janë të pabazuara dhe të pa argumentuara sepse nuk janë ofruar prova për parregullsinë e pretenduar për të vërtetuar shkeljen e supozuar. PZAP-i, vlerëson se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante, andaj në kuptim të nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 981/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.